

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6752  
E martë, 8 nëntor 2022  
çmimi 0.40 €

## Presidenti Biden i dërgon letër Begajt

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SHBA-ja DHE BE-ja TË SHQETËSUARA PËR MUNDËSINË E TENSIONEVE NË VERI



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë shprehur shqetësime në lidhje me mundësinë e tensioneve në veri. ShBA-ja dhe BE-ja u kanë bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zgjedhin rrugën e bisedimeve dhe të përmbahen nga veprimet

që do të çonin në dhunë dhe përplasje. Dhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik parlamentar Lista Serbe kanë dorëzuar të hënën dorëheqje të parevokueshme, ndërsaq 578 zyrtarë policorë të komunitetit serb kanë dhënë dorëheqje deri më tani

## BALLKANI PERËNDIMOR NGEÇËN NË INTEGRIMIN E MINORITETEVE

FAQE 7



## PAS OPERIMIT OSMANI DEL NË PUNË, TAKON AMBASADORIN JAPONEZ

FAQE 7

## AKTUALE



## BIDENI DHE TRUMPI TENTOJNË T'I BINDIN VOTUESIT PARA ZGJEDHJEVE PËR KONGRES F. 2

## MEHAJ: I VETMI KËRCËNIM PËR KOMUNITETIN SERB JANË GRUPET E DIRIGJUARA NGA BEOGRADI F. 3

## RAMA PRET AMBASADOREN E SHBA-së NË OKB: SHQIPËRIA, PARTNERE E JASHTËZAKONSHME E AMERIKËS F. 7

## EKONOMI



## KEDS-i I ZË 156 PERSONA DUKE VJEDHUR ENERGINË ELEKTRIKE F. 8

## TAHIRI: BUXHETI I 2023-S PO DËMTON POLITIKISHT PJESËN MË TË MADHE TË KOMUNAVE F. 8

## SPORT



## LIGA E KAMPIONËVE ME SUPERPËRBALLJE, PSG - BAYERN DHE LIVERPOOL - REAL F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Bideni dhe Trumpi tentojnë t'i bindin votuesit para zgjedhjeve për Kongres

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Presidenti amerikan Joe Biden dhe ish-presidenti Donald Trump kanë mbajtur tubime teksa fushata për zgjedhjet që mund ta riformësojnë Kongresin hyri në ditën e fundit. Bideni dhe Trumpi u bënë thirrjet e fundit votuesve në Nju-Jork, respektivisht në Florida. Kohët e fundit momentum është zhvendosur drejt republikanëve, të cilët po përpiqen të marrin nga demokratët kontrollin e dy dhomave të Kongresit. Republikanët konsiderohen favoritë për të fituar në Dhomen e Përfaqësuesve, por fitorja në Senat ende paraqet sfidë, kanë sugjeruar sondazhet. Marrja e kontrollit të një prej dhomave të Kongresit nga republikanët do të paraqiste një pengesë të madhe për agjendën legjislative të presidentit Biden. Me fushatën që përmbyllet të hënën, partia e Bidenit po bëhet gati të humbë edhe në ato pjesë të shtetit ku demokratët zakonisht dalin mirë në zgjedhje. Biden foli para votuesve në Nju-Jork të dielën, në mbështetje të guvernatores Kathy Hochul, e cila po sfidohet nga kandidati

republikan që ka mbështetjen e Trumpit, Lee Zeldin. Hochul ka marrë mbështetjen e disa prej figurave më të njohura të demokratëve - nga ish-presidenti Bill Clinton, nënpresidentja Kamala Harris dhe ish-sekretarja e Shtetit, Hillary Clinton. Gjatë fjalimit, Bideni tha se zgjedhjet ishin "pikë kthese" që do të përcaktojnë 20 vjetët e ardhshëm. Ai u tha votuesve amerikanë se ata do të zgjedhin midis dy "vizioneve fundamentalisht të ndryshme për Amerikën". Ndërkaq, paraardhësi i tij, Donald Trump, mori pjesë në një tubim në Majami, në mbështetje të Marco Rubios, që po garon edhe për një mandat. Ish-presidentit amerikan për më shumë se një orë kritikoi demokratët, duke i akuzuar se po e çojnë vendin drejt "komunizmit". "Demokratët duan ta shndërrojnë Amerikën në Kubën komuniste apo Venezuelën socialiste", tha Trumpi. "Të gjithë amerikanëve hispanikë në Florida dhe në mbarë vendin ne i mirëpresim me krahë hapur në Partinë Republikane", shtoi ai. Trumpi, po ashtu, vazhdoi të linte



të kuptohej se do të garojë sërish për president në zgjedhjet e vitit 2024, duke u kërkuar votuesve ta presin pjesëmarrjen e tij në tubimin e së hënës në Ohajo. Sondazhet sugjerojnë se demokratët kanë të ngjarë që ta humbin shumicën në Dhomen e Përfaqësuesve. Kontrolli i Senatit me gjasë do të

varet nga rezultatet e garave të ngushta në Pensilvani, Gjorgia dhe Nevada. Më shumë se 40 milionë votues veçse kanë votuar për zgjedhjet në Kongres që, sipas ekspertëve, është numër më i lartë sesa në zgjedhjet e vitit 2018. Por, votimet me postë zakonisht marrin më shumë kohë të

numërohen sesa votimet e rregullta, duke bërë që rezultatet në shumë shtete të mos jenë definitive gjatë mbrëmjes së të martës. Në shumë shtete kyçe, sikurse Uiskonsin dhe Pensilvani, zyrtarëve zgjedhorë nuk u lejohet që ta nisnin numërimin e votave deri në ditën e zgjedhjeve.

## Zelensky paralajmëron sulme të reja ruse ndaj infrastrukturës së energjisë

KIEV, 7 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka thënë ukrainasve që të përgatiten për sulme të tjera të mundshme ruse mbi infrastrukturën e energjisë, teksa kryetari i Kievit u ka thënë banorëve të kryeqytetit të Ukrainës që ta shqyrtojnë largimin e përkohshëm nëse qyteti humb furnizimet me rrymë dhe ujë. Gjatë adresimit në orët e vona të 6 nëntorit, Zelensky tha se Rusia po "përqendron trupat dhe mjetet e saj për sulme të reja masive ndaj infrastrukturës sonë. Pikë së pari ndaj energjisë". Mbi 4.5 milionë konsumatorë veçse kanë mbetur pa energji, shtoi ai, mes shqetësimeve se mbështetja për Ukrainën mund të zbehet pasi ndikimi i luftës në çmimet e energjisë dhe ushqimit vazhdon edhe gjatë dimrit. Më herët, kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, tha se nuk mund ta përjashtojë mundësinë që kryeqyteti ukrainas të mbesë pa ujë dhe energji si rezultat i sulmeve shkatërruese ruse ndaj infrastrukturës së energjisë. Gjatë muajit të kaluar ushtria ruse ka shënjestruar infrastrukturën e energjisë ukrainase, duke shkakuar ndërprerje të energjisë



në vend. Më 6 nëntor në Kiev ka pasur reduktime të energjisë. Kiev planifikon që të dislokojë

afër 1 000 qendra ngrohëse, por është e paqartë nëse do të jenë të mjaftueshme për 3 milionë

banorët e qytetit. Reduktive të energjisë, po ashtu, janë planifikuar në rajonet e

Çernihivit, Çerkesit, Zhitomirit, Sumit, Harkivit dhe Potlavës, ka thënë operatori i energjisë në Ukrainë, Ukrenergo. Këshilltari presidencial Mykhaylo Podolyak ka thënë se Ukraina do të "qëndrojë" pavarësisht prej sulmeve ruse ndaj infrastrukturës së energjisë, duke forcuar mbrojtjen ajrore, duke mbrojtur infrastrukturën dhe duke reduktuar furnizimin me energji. Përdërisa Rusia po rrit sulmet ndaj infrastrukturës civile, forcat ukrainase raportohet se po përparojnë në jug. Banorët e qytetit ukrainas të pushtuar nga Rusia, Herson, kanë pranuar mesazhe paralajmëruese në telefonat e tyre, që u bëjnë thirrje atyre që të evakohen sa më shpejt, tha ushtria ukrainase. Forcat ruse po përgatiten për kundëroftensivën ukrainase që ka për qëllim rimarrjen e qytetit të Hersonit, i cili ra në duart e rusëve në ditët e para të pushtimit. Në shtator, Rusia paligjshëm aneksoi Hersonin dhe tri rajone të tjera dhe më pas shpalli gjendje lufte në katër këto provinca. Administrata e instaluar nga Kremli në Herson veçse ka evakuuar dhjetëra mijëra banorë nga ky qytet.

## Presidenti Biden i dërgon letër Begajt

TIRANË, 7 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, gjatë takimit me përfaqësuesen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në OKB, ambasadorën Linda Thomas-Greenfield, mori një mesazh falënderimi dhe mirënjohjeje nga presidenti Biden për Shqipërinë dhe popullin shqiptar për bashkëpunimin e fuqishëm për avancimin e marrëdhënieve dypalëshe, stabilitetin rajonal dhe sigurinë globale. "ShBA-ja mbetet e përkushtuar për ta ndihmuar në mënyrë domethënëse dhe të

vazhdueshme Shqipërinë për forcimin e mbrojtjes kibernetike, përfshirë mbështetjen financiare dhe ngritjen e një grupi pune për sigurinë kibernetike", thekson Biden në mesazhin e tij. Teksa festojnë 100-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe ShBA-së, presidenti Biden nënvizon se dëshiron që partneriteti strategjik të thellohet edhe më tej dhe se do t'i mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për një rol më të madh lidhës në rajonin e Ballkanit Perëndimor.



## Mehaj: I vetmi kërcënim për komunitetin serb janë grupet e dirigjuara nga Beogradi



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se institucionet e Kosovës janë në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit. Ngritja e kapaciteteve ushtarake serbe në kufirin me Kosovën, ashtu dhe vendimi i pjesëtarëve të komunitetit serb për largim nga institucionet e Kosovës janë veprime me tentim të destabilizimit të vendit, ka thënë Mehaj.

Në "Facebook", Mehaj ka shkruar se institucionet janë në koordinim me policinë dhe KFOR-in. "Këto veprime janë pengesa e vetme që të arrihet një marrëveshje që do t'i lejonte të dyja shtetet të ecin para për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Ministria e Mbrojtjes, ashtu si dhe organet e tjera të rendit, mbetet e përkushtuar për ta garantuar sovranitetin e vendit

si dhe mbrojtjen e jetës së gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim etnie", ka shkruar Mehaj.

Ai ka theksuar se i vetmi kërcënim për komunitetin serb "janë individët dhe grupet kriminale serbe të dirigjuara nga Beogradi", "veprimtaria e të cilëve duhet ndaluar sa më parë, prandaj kemi koordinim të vazhdueshëm me Policinë e Kosovës si dhe me misionin e KFOR-it. Prandaj, apelojmë të gjithë qytetarët e vendit e specifikisht qytetarët tanë të komunitetit serb, që të jenë vigjilent, të mos manipulohen dhe të mos bien pre e dezinformatave që janë pjesë e skenarëve të orkestruar pandërprere nga Serbia dhe mekanizmat e saj të njohura e të praktikuara edhe në të kaluarën", ka shkruar Mehaj.

## Pas operimit Osmani del në punë, takon ambasadorin japonez


PRISHTINË, 7 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin jorezident të Japonisë në Kosovë, Akira Mizutani, të cilin e ka falënderuar për angazhimin e deritashëm. Japonia, sipas presidentes Osmani, është aleate dhe partnere strategjike, ndaj e ka falënderuar për mbështetjen e deritashme, duke u angazhuar për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet dy shteteve. Presidentja Osmani ka theksuar se të dy shtetet ndajnë vlerat dhe parimet e njëjta në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe çështjet

botërore.

Në këtë kontekst, presidentja Osmani ka theksuar se Kosova llogaritet në mbështetjen japoneze në procesin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Të dy bashkëbiseduesit theksuan potencialin për rritjen e bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, arsimit, teknologjisë informative, shëndetësisë, mjedisit dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët.

Osmani para një jave i është nënshtruar një operacioni kirurgjik në një spital privat në vend, ku mori shumë kritika që nuk zgjodhi spitalin publik për këtë operim.



## Në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike kryhet një operacion i rrallë dhe i komplikuar

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike të Qendrës Klinike Universitare të

Kosovës është kryer një operacioni i rrallë dhe i komplikuar. 40-vjeçes B. L., e cila ishte me infertilitet (pa

fëmijë), i janë hequr 21 miomë nga mitra, duke e ruajtur mitrën pa dëmtime. Operacioni zgjati më shumë

se katër orë dhe pacientja gëzon shëndet të mirë dhe pas trajtimit post-operativ pritet të lëshohet për në shtëpi.





## ShBA-ja dhe BE-ja të shqetësuara për mundësinë e tensioneve në veri

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë shprehur shqetësime në lidhje me mundësinë e tensioneve në veri. ShBA-ja dhe BE-ja u kanë bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zgjedhin rrugën e bisedimeve dhe të përmbahen nga veprimet që do të çonin në dhunë dhe përplasje. Dhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik parlamentar Lista Serbe kanë dorëzuar të hënën dorëheqje të përvokueshme, ndërkaq 578 zyrtarë policorë të komunitetit serb kanë dhënë dorëheqje deri më tani

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 7 NËNTOR** - Dhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik parlamentar Lista Serbe kanë dorëzuar të hënën dorëheqje të përvokueshme. Lista Serbe të shtunën bëri me dije se do të largohet nga institucionet e Kosovës për shkak të vendimit për targa.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se për dorëheqjen e dhjetë deputetëve serbë do t'i ndjekë procedurat e parapara me ligj. "Unë do t'i drejtohem presidentes [së Kosovës, Vjosa Osmani], e pastaj procedurat e tjera thonë që Presidenca i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e pastaj KQZ-ja i përgjigjet me propozimet për deputetë që vijnë nga e njëjta listë. Nëse edhe ata refuzojnë, procedura përsëritet derisa t'i plotësojmë vendet në Kuvend

nga pakica serbe", ka theksuar Konjufca pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit.

Ndërkaq Policia e Kosovës ka njoftuar se edhe të hënën ka pasur paraqitje të dorëheqjeve të punonjësve policorë të komunitetit serb në pjesën e veriut të vendit, në zonën e Drejtorisë Rajonale të Mitrovicës Veri. "Numri i njoftimeve për dorëheqje të punonjësve të uniformuar dhe të atyre civilë nga rendi publik, kufiri dhe hetimet, të cilët deri më tani i kanë dërguar njoftimet në rajonet dhe stacionet policore, ka arritur deri në pesëqind e shtatëdhjetë e tetë (578) punonjës. Disa prej tyre janë në proces të dorëzimit të pajisjeve, ndërsa disa prej tyre deri më tani i kanë dorëzuar pajisjet e tyre, për të vazhduar me kompletimin e procedurave të tjera të parapara", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia e Kosovës, ashtu siç e ka potencuar edhe më parë, ka

kapacitete për menaxhimin e situatës dhe rrethanave të krijuara në veri, ku tani, pas dorëheqjeve, në mungesë të personelit dhe kapaciteteve të mjaftueshme policore në veri, do t'i rrisë gradualisht kapacitetet policore me zyrtarë të rendit publik. "Të gjitha veprimet policore do të ndërmerren konform autorizimeve ligjore dhe kushtetuese me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe shërbimit ndaj qytetarëve, ruajtjes së rendit e qetësisë publike si dhe mbikëqyrjes dhe kontrollit kufitar", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie ka theksuar se ditët e fundit janë shtuar kërcënimet e Serbisë dhe të presidentit serb Aleksandër Vuçiq për destabilizimin e situatës në veri të vendit. Kjo, sipas Kurtit, po ndodh për shkak se Vuçiqi ka refuzuar planin franko-gjerman dhe kështu po i përdor, siç tha ai, pjesëtarët e strukturave ilegale në veri, për destabilizim. "Për shkak të refuzimit që ia kanë bërë Parisit dhe Berlinit, dhe për këtë po i përdorin ata që ende vazhdojnë t'i dëgjojnë, pra pjesëtarët të strukturave ilegale. Serbia është e interesuar për ta sabotuar dialogun dhe çfarëdo marrëveshje", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se Beogradi e ka refuzuar planin franko-gjerman dhe tash po bën drama për ta maskuar refuzimin.

Kurti u ka bërë thirrje serbëve në

veri të vendit që të mos japin dorëheqje ngaqë, siç ka thënë ai, "bojkotet nuk janë zgjidhje, institucionet nuk kanë alternativë".

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka theksuar se aktualisht situata në veri është e qetë dhe se janë duke bashkëpunuar me KFOR-in dhe EULEX-in. I pyetur për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, kërkesë edhe e partnerëve ndërkombëtarë, Kurti tha se ka nëntë vjet që përgjigjet për këtë çështje dhe se nuk ka përgjigje të re "për pyetje të vjetër".

Kurti ka deklaruar disa herë që është kundër formimit të një asociacioni njëetnik.

Serbia insiston që asociacioni të ketë kompetenca ekzekutive.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, të hënën ia ka dërguar një letër kryeministrit Albin Kurti në lidhje me situatën në veri të vendit. Në këtë letër Krasniqi ka shprehur gatishmërinë e PDK-së për t'i ndihmuar institucionet e Kosovës për ruajtjen e sovranitetit të vendit. Po në këtë letër Krasniqi i ka bërë thirrje Kurtit që të koordinohet me opozitën dhe faktorin ndërkombëtar. "Zhvillimet e fundit në pjesën veriore të vendit janë shumë shqetësuese dhe cenojnë funksionimin, stabilitetin dhe sovranitetin e shtetit tonë. Në këtë situatë, ku epilogu është i paqartë e rreziku i përshkallëzimit është evident,

komunikimi dhe harmonizimi i veprimeve të institucioneve dhe të gjithë aktorëve politikë është i domosdoshëm. Për t'i shprehur qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës, sot i kam dërguar një letër kryeministrit Kurti, të cilën këtu mund ta lexoni të plotë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook", duke bashkangjitur edhe letërën që ia ka dërguar Kurtit.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbajtur të hënën një konferencë të jashtëzakonshme për medie për zhvillimet në veri të vendit. Ai ka thënë se Kosova është duke humbur me këtë situatë sepse Serbia me strukturat e veta ka provokuar dhe ia ka arritur t'i nxjerrë institucionet e Kosovës prej veriut. "Shikoni në çfarë situatë jemi tash. Jo vetëm që na kërkohet tërheqja nga vendimi për targa, por edhe themelimi i asociacionit. Ky është dështim i qeverisë. Qytetarë të Kosovës, vlerësojeni vetë se kush është dhe për kënd punon Albin Kurti", ka thënë Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ka thënë se ikja nga Amerika është shkuarja për në Rusi. "Menjëherë të aprovohet kërkesa e Amerikës për pezullim të vendimit për targa. Kthimi tek Amerika është kthimi te siguria, te rendi dhe ligji dhe te sukseset e Kosovës. Ikja prej Amerikës është ikje në Moskë", është shprehur Haradinaj.

**BE-ja e shqetësuar për**

## mundësinë që tensionet në Kosovë të barten në rajon

Bashkimi Evropian ka përsëritur thirrjet për ruajtjen e qetësisë në Kosovë si dhe që të shmanget eskalimi i tensioneve të krijuara. Peter Stano, zëdhënës i BE-së për Çështje të Jashtme dhe Sigurisë, ka thënë në konferencën për shtyp se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë mund të kenë ndikim negativ në tërë rajonin. Ai, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth fatit të propozimit franko-gjerman për marrëveshje, dhe zhvillimeve të fundit në veri, ka thënë se "prioritetet është ulja e tensioneve". "Ende po i studiojmë përgjigjet nga palët, por tani prioriteti kryesor është që të ulen tensionet në terren. Ditët e fundit kemi parë rrezikun e madh të një eskalimi, si dhe zhvillime që sjellin në rrezik të gjitha të arriturat deri më tash. Kjo mund të ketë pasoja të mëdha jo vetëm për Kosovën dhe Serbinë, por për tërë rajonin. U bëjmë thirrje të dyja palëve që të jenë në nivel të përgjegjësisë dhe të gjejnë një zgjidhje evropiane", ka thënë Stano.

Stano ka përsëritur thirrjen ndaj Kosovës që të bëjë hapa të menjëhershëm drejt krijimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Sa i përket Asociacionit apo Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe, ky është një obligim i qartë për Kosovën që menjëherë ta themelojë, apo t'i nisë hapat e menjëhershëm për themelimin e këtij Asociacioni. Ky është një obligim ligjor i Kosovës dhe dështimi që kjo të bëhet, dëmton jo vetëm sundimin e ligjit në Kosovë, por edhe kredibilitetin e saj. Tash vërtet u takon të dyja palëve që t'i zbatojnë obligimet që dalin nga marrëveshjet e Brukselit dhe nga dialogu", ka thënë ai, duke nënvizuar se për këtë, Borrelu gjatë fundjavës kishte diskutuar me



kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "BE-ja dëshiron t'i afrojë Kosovën dhe Serbinë drejt një zgjidhjeje evropiane, t'i ulin tensionet dhe që sa më shpejt të përfshihen në dialog, sepse kjo është e vetmja rrugëdalje nga eskalimi momental. Kjo është rruga që çon deri te perspektiva evropiane për të dy partnerët", ka theksuar ai.

### ShBA-ja: Kosova dhe Serbia të përmbahen nga veprimet që mund të çojnë në dhunë

Shtetet e Bashkuara u kanë bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zgjedhin rrugën e bisedimeve dhe të përmbahen nga veprimet që do të çonin në dhunë dhe përplasje. Një zëdhënës i Ambasadës Amerikane në Prishtinë ka thënë të dielën se Shtetet e Bashkuara pajtohen me Bashkimin Evropian se

zhvillimet e fundit rreth marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë shqetësuese dhe vënë në rrezik paparimin e rëndësishëm të arritur në bisedimet e lehtësuara nga BE-ja. "Tërheqja e serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës nuk është zgjidhje e mosmarrëveshjeve aktuale dhe ka mundësi për t'i përshkallëzuar më tej tensionet në terren. Të gjitha palët e përfshira duhet të ndërmarrin hapa për t'i ulur tensionet dhe për ta siguruar paqen dhe qëndrueshmërinë. Veprimet dhe retorika që rritin mundësinë e dhunës vënë në rrezik të panevojshëm jetët e pafajshëm dhe ato të forcave paqeruajtëse ndërkombëtare në terren", ka theksuar ky zëdhënës.

Së këndejmi, ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara i bashkohen BE-së duke u bërë thirrje përfaqësuesve të Serbisë dhe serbëve të Kosovës që t'i respektojnë detyrimet e tyre të dala nga bisedimet e të kthehen

në institucionet e Kosovës për t'i përbushur detyrat e tyre, duke përfshirë policinë, gjyqësorin dhe administratën lokale. Në të njëjtën kohë, "ne përsëri i bashkohemi BE-së në thirrjet për t'u kërkuar autoriteteve të Kosovës që t'i respektojnë detyrimet e tyre pa vonesë. Kjo nënkupton zgjatjen e menjëhershme të procesit të reregjistrimit të makinave dhe pezullimin e çdo veprimi ndëshkues ndaj mbajtësve të targave KM derisa të zgjidhet çështja e targave nga palët në kuadër të dialogut". Kjo, tha zëdhënësi, gjithashtu nënkupton fillimin e menjëhershëm të negociatave për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Parlamenti i Kosovës e ka ratifikuar Marrëveshjen e Brukselit dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur që Asociacioni duhet të krijohet, gjë që e bën themelimin e tij detyrim ligjor për Kosovën.


Dështimi i vazhdueshëm i Kosovës për ta zbatuar këtë detyrim cenon parimin e sundimit të ligjit dhe dëmton reputacionin dhe besueshmërinë e Kosovës. "Është përgjegjësi e të dyja palëve të garantojnë paqen dhe qëndrueshmërinë në terren dhe veprimet, të tilla si djegia e makinave ose retorika frikësuese, janë të papranueshme dhe do të nxisin një reagim të duhur nga komuniteti ndërkombëtar, tha zëdhënësi, duke theksuar se Shtetet e Bashkuara u bëjnë thirrje palëve ta zgjedhin rrugën e dialogut dhe të përmbahen nga veprimet që do të çonin në dhunë dhe përplasje. Shtetet e Bashkuara mbështesin plotësisht përpjekjet e BE-së për të vazhduar lehtësimin e negociatave. Si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të tregojnë se janë të gatshme të kërkojnë zgjidhje në mënyrë konstruktive dhe t'i respektojnë detyrimet e tyre të dala nga bisedimet e lehtësuara nga Bashkimi Evropian", ka thënë ai.



## Nisin punimet për memorialin dhe sheshin "Afrim Krasniqi"

**MALISHEVË, 7 NËNTOR** - Në praninë e familjarëve të dëshmorit të kombit Afrim Krasniqi dhe bashkëfshatarëve të fshatit Bardh, të hënën kanë nisur punimet për ndërtimin e sheshit dhe memorialit të dëshmorit Afrim Krasniqi. I pranishëm ishte kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati me bashkëpunëtorë, nënkryetari Vesel Krasniqi, drejtorët komunalë Avdi Morina dhe Sylë Dukolli etj. Kastrati në nisjen e punimeve të sheshit dhe memorialit të dëshmorit të kombit Afrim Krasniqi, në fjalën e rastit

theksoi se sot ndihet krenar që po nisin sheshin dhe memorialin e dëshmorit të kombit Afrim Krasniqi në fshatin Bardh. "Jam i përkushtuar që porosinë e dëshmorit të kombit dhe familjarëve të dëshmorëve ta jetësojmë për brezat e tashëm dhe të ardhshëm, sepse duke kujtuar dëshmorët, ne kujtojmë luftën e tyre për çlirim, liri dhe pavarësi të Kosovës. Këto janë vlerat më sublimë të kombit dhe shenjat e kujtesës sonë që do të jetojnë sa do të jetojë kombi shqiptar", ka thënë Kastrati.



## QKMF-ja "Rexhep Kuçi" në Suharekë bëhet me aparat të ri të RTG-nit dhe Vertebrogramit

**SUHAREKË, 7 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka njoftuar se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Rexhep Kuçi" është furnizuar me aparat të ri të RTG dhe Vertebrogramit. Ai ka theksuar se shërbimet shëndetësore në komunën

që drejton janë unike dhe të pakrahasueshme. "Ky aparat digjital do të ndikojë në ngritjen e shërbimeve sa më cilësore për pacientët dhe do ta lehtësojë punën e profesionistëve shëndetësorë", ka shkruar Muharremaj në "Facebook".

## Nisën punimet për rikthimin e identitetit të Pallatit të Rinisë

**PRISHTINË, 7 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se të hënën kanë filluar punimet në Pallatin e Rinisë. "Nisën punimet për rikthimin e identitetit të

Pallatit të Rinisë - ikonë e kryeqytetit", ka shkruar Rama në "Facebook". Në postimin e tij, ai i ka publikuar edhe disa fotografi derisa janë duke u zhvilluar punimet.



## Komuna e Prizrenit dhe Edirnes e Turqisë nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



**PRIZREN, 7 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me kryetarin e komunës së Edirnes në Turqi, Recep Gurkan, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Totaj, pas nënshkrimit të këtij memorandum, ka theksuar se Prizreni po zhvillohet vazhdimisht dhe kështu do të

jetë ritmi i zhvillimit edhe në vijim. "Përmes këtij memorandum u pajtuam që të zbatojmë politika të zhvillimit në fushat si: arsimit, ekonomia, turizmi, kultura dhe sporti përmes zhvillimit të projekteve të përbashkëta dhe realizimit të aktiviteteve në komunën e Edirnes dhe në komunën e Prizrenit", ka thënë Totaj.

## Fillojnë vizitat për shërbime veterinerë falas në Rahovec

**RAHOVEC, 7 NËNTOR** - Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në komunën e Rahovecit, Berat Duraku, i shoqëruar nga veterinari i angazhuar nga komuna e

Rahovecit dhe zyrtarë të BPZhR-së, kanë filluar vizitat te fermerët blegtorë, për t'i hapur kështu rrugë parandalimit të sëmundjeve përmes vaksinimit. "Vizitat do të realizohen në baza

periodike në tërë territorin e komunës së Rahovecit, ku përmes këtij shërbimi do të arrijmë të jemi më afër fermerëve blegtorë të komunës sonë", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



## Ballkani Perëndimor ngecën në integrimin e minoriteteve

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Samiti i parë i Ballkanit Perëndimor kundër diskriminimit racor grumbulloi përfaqësues të vendeve të rajonit në Prishtinë, ku u diskutua për problemet që po e pengojnë procesin e integrimit të minoriteteve etnike në shoqëri. Drejtori i organizatës Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve, Isak Skënderi, tha se Kosova dhe shtetet e tjera ballkanike kanë ngecur në procesin e integrimit të komuniteteve minoritare si të atij rom. "Sot, në Kosovë, ashtu si edhe në shtetet e tjera ballkanike, romët janë të ngujuar në një qark vicioz të përjashtimit. Atyre u mungojnë mundësitë dhe mungojnë shërbimet", u shpreh Skënderi, duke shtuar se qëllimi kryesor i tij është të punohet drejt një shoqërie "me të vërtetë shumetnike në Kosovë".

Se gjendja e komuniteteve minoritare nuk është e mirë, tha edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Ai shtoi se, përveç ndërgjegjësimit institucional, duhet të punohet edhe për vetëdijesimin shoqëror. "Gjendja e komuniteteve nuk është e mirë si nga aspekti i diskriminimit, ashtu edhe nga ai i varfërisë dhe mungesës së mundësive në aspektin socio-ekonomik", u shpreh Kurti, teksa shtoi se arsimimi dhe punësimi janë problemet kryesore në procesin e integrimit.

Mbi 90 për qind e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë të papunësuar, sipas Zyrës për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, ndërsa për nivelin e edukimit të tyre nuk ka të dhëna.

Probleme të ngjashme lidhur me diskriminimin racor hasin edhe minoritetet etnike në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, sipas Fatmir Gjekës, ministër i të Drejtave të Njeriut dhe



Minoriteteve në Mal të Zi. Ai tha se "kjo çështje nuk është çështje e një vendi, porse problemet janë të përbashkëta".

Gjeka bëri me dije se me gjithë sfidat me të cilat përballen ende këto komunitete në rajon, Mali i Zi ka ndërmarrë disa hapa, si: financimin e udhëtimit për në shkollë, ndarjen e bursave dhe mbështetjes financiare për nxënës nga komunitetet minoritare.

Në Kosovë, në tetor të këtij viti, Ministria e Arsimit ndau 100 bursa për studentë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që studiojnë në Fakultetin e Edukimit, ndërsa 500 bursa të tjera janë ndarë për studentë në drejtime të

ndryshme.

Artan Grubi, ministër i Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Komuniteteve në Maqedoninë e Veriut, tha se edhe vendi i tij po angazhohet vazhdimisht t'i zhdukë paragjykimet dhe diskriminimin racor në shoqëri. "Legjislatura duhet të përcillet me procesin e vështirë të çlirimit të çdo njeriu nga paragjykimet që ka për të tjerët", u shpreh Grubi, duke shtuar se ka raste kur prindërit vendosin t'i dërgojnë fëmijët në shkollë më të largëta vetëm për të mos i lënë fëmijët e tyre në shkollë me shumë nxënës të komuniteteve minoritare.

I pranishëm në këtë Samit, ku fokusi ishte te komunitetet rom,

ashkali dhe egjiptian, ishte edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Ai foli për sfidat që vetë ShBA-ja ka kaluar në luftën kundër diskriminimit racor, teksa tha se mësimi kryesor për të gjithë është që "të mos jemi tolerantë ndaj jotolerancës". "Nuk duam që të kemi Betimin e Hipokratit, që të mos bëjmë keq. Duam të kemi standard më të lartë. Duhet të kemi një angazhim të qëndrueshëm", u shpreh Hovenier.

Ndërsa shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, tha se edhe Evropa është përballur me sfida të tilla për shekuj me radhë, por tani ka politikën e "zero tolerancës ndaj çfarëdo forme të

diskriminimit". "Dua ta përfundoj fjalimin duke e njohur të gjithë punën që është ndërmarrë, por edhe si përkujtues i të gjitha sfidave që duhet ende t'i tejkalojmë për t'ua përmirësuar jetën atyre që janë më të cenueshëm", u shpreh Szunyog.

Ambasadori i BE-së u shpreh i kënaqur me vendimin e javës së kaluar të komunës së Prizrenit për ta njohur gjuhën rome si gjuhë zyrtare në këtë komunë. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, në Kosovë jetojnë 8 824 romë, 15 436 ashkalinj dhe 11 524 egjiptianë. Në radhët e komuniteteve të tjera në Kosovë bëjnë pjesë: serbët, turqit, boshnjakët dhe goranët.

## Rama pret ambasadorin e ShBA-së në OKB: Shqipëria, partnere e jashtëzakonshme e Amerikës



TIRANË, 7 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka pritur të hënën në një takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kombet e Bashkuara, Linda Thomas-Greenfield, anëtare e kabinetit të presidentit Joe Biden.

Kryeministri Rama vlerësoi vizitën e ambasadores si një moment i rëndësishëm në kuadrin e bashkëpunimit në Këshillin e Sigurimit.

Ambasadorja Linda Thomas-Greenfield vlerësoi partneritetin dhe bashkëpunimin me qeverinë shqiptare dhe popullin shqiptar. "Unë kam pasur përvojën që të punoj në Këshillin

e Sigurimit me ambasadorin Hoxha. Ai ka qenë partner i jashtëzakonshëm dhe fqinj i jashtëzakonshëm në Këshill. Ne kemi qenë të njëjtë mendim. Dhe në atë Këshill, në momentin që ulemi të 15 në ato karrige, të gjithë jemi të barabartë, zërat tanë janë të barabartë dhe zëri juaj në këshill ka qenë tejet i fortë, tejet i respektuar dhe kemi ndarë të njëjtën mendësi dhe kjo ka qenë një nga marrëdhëniet më të rëndësishme që kam pasur mes 10 anëtarëve të zgjedhur të Këshillit", ka theksuar Linda Thomas-Greenfield, duke i falënderuar qytetarët shqiptarë për partneritetin e tyre të jashtëzakonshme.

## KEDS-i i zë 156 persona duke vjedhur energjinë elektrike

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Kompania Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njoftuar se planet dhe aksionet për kontrolle të keqpërdorimeve të ekipeve të Departamentit të Humbjeve në KEDS vazhdojnë të implementohen në tërë Kosovën çdo ditë. "Vetëm gjatë javës së kaluar në të gjitha distriktet dhe nëndistriktet janë

kryer 1 930 kontrolle të konsumatorëve të energjisë elektrike, për të cilët dyshohej se po keqpërdornin rrymën. Prej tyre 156 u vërtetua se po e anashkallonin matjen e saktë të energjisë elektrike", ka njoftuar KEDS-i.

Sipas KEDS-it, keqpërdorimi i energjisë elektrike është i papranueshëm dhe i dënueshëm. "Keqpërdorimi i

energjisë elektrike dënohet me ligjet e Kosovës. Raportoheni keqpërdorimin përmes Qendrës së Thirrjes në numrin pa pagesë: 0800 791 00, përmes emailit, rrjeteve sociale ose në zyrrat tona. Raportimi juaj do të mbetet konfidencial. Rastet e tilla ekipet e KEDS-it do t'i parashtrajnë për procedura të mëtutjeshme gjyqësore", ka njoftuar KEDS-i.



## BE-ja ndan 18 miliardë euro ndihma të reja për Ukrainën

BRUKSEL, 7 NËNTOR - Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e informoi presidentin ukrainas Vlodimir Zelensky për një paketë të re ndihmesh me vlerë 18 miliardë euro. Ndihmat janë planifikuar të jepen në këste mujore prej 1.5 miliardë eurosh secili, njoftoi Komisioni i BE-së. Në bisedën telefonike që zhvilloi Ursula von der Leyen me Zelenskyn u tha se kreditë do të japin një "kontribut të rëndësishëm" për nevojat financiare të Kievit për vitin 2023.

Fondet do ta mbështesin gjithashtu Ukrainën për të zbatuar reforma të mëtejshme

në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE.

Zelensky njoftoi në "Twitter" se kishte folur me von der Leyen për mbështetje financiare për vitin aktual dhe vitin e ardhshëm. Një tjetër temë ishte eksporti i drithit nga Ukraina nëpërmjet Detit të Zi si kontribut për sigurinë globale të ushqimit.

Një marrëveshje e ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara dhe Turqia në korrik, e cila synon t'i sigurojë eksportet e drithit nga Ukraina, është fillimisht e vlefshme deri më 19 nëntor dhe Rusia e ka lënë të hapur zgjatjen e saj.



## Komisioni për Ekonomi miraton Projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore



PRISHTINË, 7 NËNTOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i drejtuar nga Ferat Shala, kryetar, të hënën ka shqyrtuar raportin me rekomandime për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg. Ndonëse debati për këtë projektligj kishte përfunduar, pas rekomandimeve nga Bashkimi Evropian, anëtarët e

komisionit debatuan dhe shqyrtuan Projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg.

Me këtë rast rekomandimet e dhëna u bënë pjesë e këtij projektligji, duke marrë kështu mbështetjen me votë nga shumica e anëtarëve të komisionit.

Projektligji me raportin me rekomandime procedohet më tutje për shqyrtim të mëtutjeshëm.

## Tahiri: Buxheti i 2023-s po dëmton politikisht pjesën më të madhe të komunave

PRISHTINË, 7 NËNTOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se buxheti i 2023-s po dëmton politikisht një pjesë të madhe të komunave. Tahiri në një konferencë për medie ka theksuar se është shumë me rëndësi që të procedohet në Kuvend edhe Projektligji i Pagave. "Për grupin parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka rëndësi Ligji për Buxhetin, i cili është duke e dëmtuar politikisht një pjesë të madhe të

komunave. Është shumë me interes edhe Ligji i Pagave dhe ligjet vitale të vijnë në Kuvend e të mos jemi peng i politikës", ka thënë Tahiri.

Në fund të muajit tetor, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për buxhetin e vitit 2023, i cili pritet të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro. Një miliard e 98 milionë euro janë ndarë për subvencione e transfere, 811 milionë për shpenzime kapitale, 745 milionë të tjera në kategorinë paga dhe mëditje dhe 493 milionë euro për mallra dhe shërbime.





# Pse kaosi brenda turmave është kaq shumë vdekjeprurës?



## Nga Armani SYED

Festimet e Halloween në Korenë e Jugut u shndërruan në skena makthi të shtunën e kaluar, ndërsa një kaos brenda turmës shkaktoi vdekjen e të paktën 153 njerëz në një lagje me rrugëshumë të ngushta në Seul, kryeqytetin e vendit. Ngjarja më vdekjeprurëse e këtij lloji në historinë e Koresë së Jugut, ndodhi në distriktin Itaewon, qendër e njohur e komunitetit LGBTQ. Rreth 100.000 njerëz ishin mbledhur jashtë klubeve dhe bareve të Itaewon për të festuar Halloween për herë të parë në 3 vite, për shkak të kufizimeve të mëparshme nga Covid-19. Të pranishmit e veshur me kostumet tradicionale të kësaj feste, u bllokuan dhe nisën tështypnin njëri-tjetrin për shkak të numri të madh të të pranishmëve. Po pse lëvizjet kaotike të turmave janë kaq të rrezikshme, dhe çfarë duhet të bëni nëse gjendeni në një moment të tillë?

### Si ndodh përplasja brenda turmës

Moskuptimi se për çdo hapësirë të kufizuar, ka një kapacitet të kufizuar maksimal, është arsyeja kryesore pse ndodhin katastrofa të tilla. "Ekziston një degë e gjeometrisë që krijon turma me densitet të lartë, e cila nga ana tjetër mund të shkaktojë rritje progresive të turmave"- thotë

G.Keith Still, ekspert i sigurisë së turmave, lektor në Universitetin Suffolk.

Still nënvizon se me çdo trup shtesë që i bashkohet një turme, rritet edhe potenciali për të krijuar një forcë mbizotëruese. Duke komentuar tragjedinë e Itaewon, ai thotë se rrugica e ngushtë ishte në një tatëpjetë me dy rrugë të kundërta. "Kjo është një gjeometri tipike që ka shkakuar incidente të ngjashme me shumë të vdekur edhe në të kaluarën"- thekson ai.

Në SHBA, ngjarja më e fundit e këtij lloji ndodhi në dhjetorin e vitit 2021, kur 10 persona humbën jetën gjatë një koncerti të Trevis Skot në "Astroworld" në Hjuston. Në fillim të këtij muaji, një përplasje brenda turmave në një stadium futbollit në Indonezi, shkaktoi të paktën 125 të vdekur në atë që ishte një nga incidentet më vdekjeprurëse në botë në një aktivitet sportiv.

### Po pse përplasjet brenda një turme janë kaq vdekjeprurëse?

Nëse grupime të mëdha njerëzish grumbullohen së bashku, duke pasur një nivel të lartë kontakti personal, dendësia mund të tejkalojë shpeshherë kufirin e sigurisë, dhe kjo mund tabëjë të vështirë frymëmarrjen për shumë njerëz, madje edhe para se të ndodhë ndonjë incident.

Kur njerëzit përpiqen të arratisen, çdo lëvizje e vogël përforcohet nga turma, dhe kjo çon në një valë të përforcuar, apo në një

efekt domino, ku të pranishmit fillojnë të shtyhen kundër njëri-tjetrit. "Një lëvizje e vogël mund të krijojë efekte shumë të mëdha. Kur zona ka pjerrësi, atëherë ndodh një rrëshqitje dhe rrëzim. Njerëzit bien mbi njëri-tjetrin, dhe këtu nisin problemet. Ndërsa përpiqen të ngrihen, krahët dhe këmbët përdridhen së bashku, ndërpritet furnizimi me gjak, oksigjeni po ashtu, nuk mund të merret dot frymë, dhe kjo sjell asfiksion që është shkak më i mundshëm i vdekjes në këto raste"- thotë eksperti.

### Ç'duhet të bëni nëse gjendeni brenda një turme

Still thotë se është më mirë të marrësh pjesë në tubime të mëdha duk pasur një vetëdije të avancuar mbi situatën: "Hidhni një sy përreth jush. Dëgjoni zhurmën e turmës. Kuptojeni qënësë ndodhëni në një situatë me densitet të lartë, mund të jetë shumë e vështirë të dilni prej andej. Nëse ndjeni se vendi është i mbipopulluar, dhe nëse nuk ndiheni i sigurt, thjesht mos shkoni atje".

Këshilla e tij për organizatorët e ngjarjeve është të analizojnë hapësirën, të njohin kapacitetin e saj, dhe të menaxhojnë fluksin në ato zona për t'i mbajtur të sigurt njerëzit. Këto vlerësimeparaprake të rrezikut do të shpëtojnë jetë njerëzore në planin afatgjatë. Është shumë e vështirë që të çlirohesh nga një turmë, paralajmëron

Still.

Por nëse e gjeni veten në një turmë, Qendra e SHBA-së për Kontrollin dhe Parandalimin e sëmundjeve ka këshilla. Agjencia shëndetësore këshillon që t'i mbani duart para gjoksit "si një boksier", të shtërngoni këmbët dhe të përpiqeni të qëndroni në këmbë. Nëse rrëzoheni, thotë CDC, ngrihuni sa më shpejt që të jetë e mundur dhe kur të ketë qetësi, nisni të lëvizin në mënyrë diagonale për të dalë jashtë turmës.

### Çfarë është shtypja nga turma?

Kjo është një ngjarje ku njerëzit kanë hapësirë për të ikur nga një burim rreziku, dhe kjo lëvizje kolektive krijon një rrezik të madh. "Largimi i një turme shkakton rral-lëherë incidente. Mund të ketë një reagim 'lufto ose ik' ku njerëzit që largohen me vrap nga njëkërcënim, për shembull nga një person që gjuan më armë, dhe kanë hapësirë për të lëvizur"-shpjegon Still.

Në shtatorin e vitit 2015, të paktën 1.470 njerëz u vranë gjatë Haxhit, një pelegrinazh islamik në Arabinë Saudite, si rezultat i një përplasjeje dhe kaosi brenda turmës së madhe. Para tragjedisë së vitit 2015, gjatë pelegrinazhit vjetor kishte pasur edhe disa tragjedi të tjera me më pak viktime. / "Time" - Bota.al

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

## Liga e Kampionëve me superpërballje, PSG - Bayern dhe Liverpool - Real

**NION, 7 NËNTOR** - 16 skuadrat më të mira në Evropë mësuan rivalët e tyre në fazën e 1/8 në Ligën e Kampionëve. Shorti i hedhur në Nyon të Zvicrës ka përcaktuar dy përballje të zjarra mes klubeve gjigante që llogariten favorite për ta fituar trofeun më të rëndësishëm në futboll, Ligën e Kampionëve. PSG do të përballlet me Bayern Munchenin, kurse Liverpooli do të ketë përballë kampionin në fuqi të kësaj gare, Real Madridin. Kampioni i Serisë A, Milan, gjen në fazën e 1/8 Tottenhamin e drejtuar nga Antonio Conte. Short me fat për Interin që do të përballlet me Porton. Manchester City i Pep

Guardiolës, një nga favoritët e këtij edicioni, do të përballlet në fazën e 1/8 me ekipin e Leipzigit. Ndeshjet e para të raundit të 1/16 do të luhen më 14/15 dhe 21/22 shkurt 2023, kurse ndeshjet e kthimit më 7/8 dhe 14/15 mars 2023. Shorti për çerekfinalet dhe gjysmëfinalet mbahet më 17 mars 2023, kurse ndeshja e parë çerekfinalet më 11/12 prill 2023. Ndeshja e kthimit çerekfinale më 18/19 prill 2023. Ndeshja e parë gjysmëfinale zhvillohen më 9/10 maj, kurse ato të kthimit më 16/17 maj. Finalja: 10 qershor 2023 në stadiumin Ataturk në Stamboll (Turqi).

**DRAW RESULT**

FC SALZBURG (AUT)	vs	FC BAYERN MÜNCHEN (GER)
SPORTING CLUBE DE PORTUGAL (POR)	vs	MANCHESTER CITY FC (ENG)
SL BENFICA (POR)	vs	AFC AJAX (NED)
CHELSEA FC (ENG)	vs	LOSC LILLE (FRA)
CLUB ATLÉTICO DE MADRID (ESP)	vs	MANCHESTER UNITED FC (ENG)
VILLARREAL CF (ESP)	vs	JUVENTUS (ITA)
FC INTERNAZIONALE MILANO (ITA)	vs	LIVERPOOL FC (ENG)
PARIS SAINT-GERMAIN (FRA)	vs	REAL MADRID CF (ESP)

### ÇIFTET E 1/8 SË FINALES:

- Leipzig - Manchester City
- Club Brugge - Benfica
- Liverpool - Real Madrid
- Milan - Tottenham
- Frankfurt - Napoli
- Dortmund - Chelsea
- Inter - Porto
- PSG - Bayern Munchen

## Shorti i Ligës së Evropës: Barcelona përballë Unitedit



### ÇIFTET NË LIGËN E EVROPËS

- Barcelona - Manchester United
- Juventus - Nantes
- Sporting - Midtjylland
- Shakhtar Donetsk - Stade Rennais
- Ajax - Union Berlin
- Bayer Leverkusen - Monaco
- Sevilla - PSV
- Salzburg - Roma

**Nion, 7 nëntor** - U hodh në Nion të Zvicrës edhe shorti i Ligës së Evropës që përshiu tetë skuadrat e ardhura nga Liga e Kampionëve, mes të cilave Juventus dhe Barcelona dhe tetë skuadrat e kualifikuara si të dyta në fazën e grupeve të këtij kompeticioni. Vendet e para të fazës së grupeve kalojnë menjëherë në raundin tjetër, ndërsa në këtë raund do të përballen tetë skuadrat e vendeve

të dyta në Ligën e Evropës dhe tetë skuadrat që vijnë nga Liga e Kampionëve. Tetë skuadrat që janë kualifikuar në fazën tjetër janë Arsenali, Fenerbahçe, Betisi, Royale Union SG, Real Sociedad, Feyenoordi, Freiburg dhe Ferencvaros. Supersfida e këtij raundi do të jetë Barcelona - Manchester United, me Ronaldon që do të përballlet me një nga ekipet rivale të përherëshme.

## Përballje interesante në Ligën e Konferencës

**NION, 7 NËNTOR** - Të hënën është bërë hedhja e shortit edhe për Ligën e Konferencës, garë kjo që zhvillon edicionin e dytë, pjesë e së cilës në fazën e grupeve ishte edhe Ballkani i Suharekës, por që nuk arriti kalimin nga Grupi G. Takim interesant pritet të jetë në mes të Trabzonsporit dhe Baselit, kurse Lazio do të ketë punë me CFR Clujin, skuadër e cila ishte një grup me skuadrën e Ballkanit.

### ÇIFTET NË LIGËN E KONFERENCËS

- Qarabag FK - KAA Gent
- Trabzonspor - Basel 1893
- Lazio - CFR Cluj
- Bodo/Glimt - Lech Poznan
- Braga - Fiorentina
- Larnaca - Dnipro
- Sheriff Tiraspol - Partizan
- Anderlecht - Ludogorets



## Kosova më 19 nëntor mëson kundërshtarin për fazën e dytë

**Prishtinë, 7 nëntor** - Të dielën ka përfunduar faza e parë kualifikuese për Kampionatin Botëror të Hëndbollisteve që vitin e ardhshëm mbahet në Danimarkë, Norvegji dhe Suedi. Janë përcaktuar nëntë ekipet kombëtare që do të

luajnë në fazën e dytë. Për herë të parë në fazën e dytë do të jetë edhe Kombëtarja e Kosovës, pas suksesit historik të arritur në ndeshjet ndaj Ishujve Faroe. Shorti për fazën e dytë do të tërhiqet më 19 nëntor në Lubjanë. Kosovës

në fazën e dytë i janë bashkuar Austria, Sllovakia, Islanda, Turqia, Italia, Ukraina, Portugalia dhe Greqia. Këto nëntë kombëtare si dhe Çekia do të luajnë në fazën e dytë me dhjetë ekipe kombëtare që aktualisht po paraqiten në

“Euro 2022”. Fituesit do të shkojnë në Botëror. Pra Kosova e ka vetëm edhe një pengesë para Botërorit. Kalimi i saj do të ishte sukses i jashtëzakonshëm. Ndeshjet e fazës së dytë luhen në pranverë.



## KH Besa kualifikohet në raundin e tretë të Kupës Evropiane

PEJË, 7 NËNTOR - Kampionia e Kosovës në Hendboll, Besa Famgas, është kualifikuar në raundin e tretë të Kupës Evropiane për hendbollistë. Në palestrën "Karagaçi" në Pejë, Besa Famgas e mposhti skuadrën nga Finlanda, IFK Handball Helsinki, me rezultat 35:32. Dhe kjo fitore i ka

mundësuar që të avancojë në raundin e tretë. Në Helsinki para një jave Besa kishte pësuar me një gol dallim, 28:27. Mysafirët e nisën më mirë ndeshjen dhe deri në minutën e 15-të ishin në epërsi prej një goli disa herë. Ndërkohë Besa vetëm barazonte rezultatin. Më pas

ekipi pejan u shkëput deri në tri gola, kurse rezultati pas pjesës së parë ishte 18:15. Finlandezët u kthyen në pjesën e dytë dhe barazuan rezultatin në 20:20 e më pas në 21:21 e 22:22. Por Besa bëri shkëputje tjetër, këtë herë deri në pesë gola (29:24, 30:25, 31:26). Helsinki prapë u afrua në

32:30. Fare në fund shënoi Jon Vokshi për 35:32. Egzon Gjuka udhëhoqi Besën me 9 gola nga 10 tentime. Nikola Prce, që e luan edhe rolin e trajnerit, i shënoi 7 gola nga 8 tentime. 5 gola nga 6 tentime i kishte Victor Alonso. Vokshi e Denis Shabanoviq i shënuan nga 4 gola.



## Suarezi largohet mes lotësh nga Nacionali

MONTEVIDEO, 7 NËNTOR - Luis Suarez u rikthye në vendlindje për ta veshur përsëri fanellën e klubit të zezërës Nacional. Sulmuesi uruguaian luajti në 16 ndeshje duke dhënë kontributin e tij me tetë gola e tri asistime. Nacional arriti të fitojë titullin e kampionit në Uruguai dhe sulmuesi veteran është i gëzuar që ka dhënë kontribut. 35-vjeçari është larguar nga Nacionali pas tre muajve qëndrim dhe këtë e ka bërë në mënyrë emocionuese në festën e titullit. "Ka ardhur koha dhe, para së gjithash, dua t'ju falënderoj për gjithçka. Siç thashë pak më parë, u ktheva për ju dhe sepse doja të kthehesha. Secili nga ju duhet të vazhdojë të jetë krenar që jemi në një nivel global dhe njerëzit flasin për atë që bënë tifozët e Nacionalit dhe kjo është merita juaj. Dua t'ju falënderoj shokët e mi të skuadrës. Ata mund të kenë



mësuar diçka, por unë po marr me vete një grup fantastik. Po marr me vete kujtimin e të gjithëve dhe dua t'ju falënderoj këta tre bukuroshë të mrekullueshëm (për djemtë e tij që e shoqëruan) që më dhuroi gruaja ime", ka thënë Suarez. "Ta shohë veten të dal

kampion me fanellën që kam lindur këtu është një ëndërr e realizuar. Shihemi më vonë, nuk do të luaj më, por nuk dihet nëse do të rikthehem në klub pas një kohe", ka deklaruar Suarez, i cili pritet të transferohet në elitën e futbollit amerikan.

## Lakersat dhe Clippersat në krizë, Toronto 'leksion' Bullsave

LOS ANXHELOS, 7 NËNTOR - Humbja e dytë radhazi, e shtata sezonale për skuadrën e lakersave, që nuk arrin të dalë nga kriza. Kalifornianët u mundën 114-110 në fushën e tyre nga Clevelandit. LeBron James realizoi 27 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për miqtë u dalluan Mitchell me 33 pikë e Donovan me 24 pikë. Humbet edhe ekipi tjetër i Los Anxhelosit, ai i Clippersave, që u mund 110-102 nga Utah Jazzi. Clarkson me 23 pikë e Sexton me 22 bënë diferencën në fushë për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 34 pikët



e Paul Georges. Pa probleme fitoi edhe Toronton, që në fushën e tij mundi me rezultat 113-104 Chicagon, një përballje mes dy ekipeve pretendente në Lindje. VanVleet me 30 pikë e 11 asistime

ishte më i miri për kanadezët. Nuk zhgënjën as Memphisit, forca e tretë në Perëndim, që mundi me rezultat 103-97 Washingtonin, takim ku u dallua Bane me 28 pikë.

### REZULTATET

Lakers - Cleveland	100-114
Memphis - Washington	103-97
Toronto - Chicago	113-104
Clippers - Utah Jazz	102-110

## Joshua do të boksojë në mars

Anthony Joshua do të rikthehet në ring në mars të vitit tjetër. Rivali i tij do të dalë nga sfida mes Dillian Whyte dhe Jermaine Franklin, duel që do të zhvillohet më 26 nëntor në

Londër. Lajmin e konfirmoi Eddie Hearn, menaxher i Joshuas dhe promotori i sfidave të boksit. "Ka shumë emra që janë përmendur muajt e fundit për të dueluar me Joshuan.

Disa prej tyre janë Otto Wallin apo Filip Hrgoviq, që i vlerësojmë. Gjithsesi, unë mendoj se futesi i duelit mes Whyte dhe Franklin do të jetë sfidanti i Joshuas në ring vitin

tjetër", ka thënë Hearn. "Të paktën ky është plani ynë, që futesi i kësaj sfide të ngjitet në ring, duke qenë në 'pole'. Ne dëshironim që sfida të zhvillohej në shkurt, por

ndoshta muaji mars është më i përshtatshëm, duke i dhënë mundësi rivalit të rikuperojë. Gjithsesi, deri në fund të nëntorit nuk do të kemi risi", ka deklaruar Hearn.

### SHKURT

#### Dabiqaj, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, kanë dhënë çmimin "Ylli i javës" pas çdo xhiroje në elitë. Çmimi i më të mirit për javën e 15-të i ka takuar futbollistit të SC Gjilani, Albert Dabiqaj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit. Dabiqaj pati paraqitje shumë të mirë në duelin ndaj Prishtinës dhe ishte më i merituari që Gjilani arriti ta arkëtojë një pikë në stadiumin "Fadil Vokrri". Ai, përveç lojës së mirë gjatë tërë ndeshjes, arriti të shënojë dy gola për skuadrën e tij në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri", e cila u mbyll baras 2:2.

#### Southamptoni shkarkon trajnerin Hasenhuttl

Southamptoni e ka shkarkuar Ralph Hasenhuttlin nga detyra e trajnerit pas rezultateve të dobëta dhe renditjes në Premierë Ligë. Lajmin e ka bërë me dije vetë klubi me anë të një njoftimi në faqen zyrtare, duke falënderuar 55-vjeçarin për punën e përshtatshme në këto katër vjet në drejtimin e skuadrës. Hasenhuttl e mori drejtimin e Southamptonit më 6 dhjetor 2018 teksa ka numëruar 173 ndeshje në të gjitha kompeticionet ku ka arritur 60 fitore, 38 barazime dhe 75 humbje. Aktualisht në 14 ndeshje në kampionat, Southamptoni renditet në vendin e 18-të me 12 pikë, teksa ka koleksionuar 3 fitore, 3 barazime dhe 8 humbje.

#### Coutinho humb Kupën e Botës

Ylli i Aston Villës, Philippe Coutinho, nuk do të luajë në "Katar 2022", i cili do të fillojë më 20 nëntor. Futbollisti brazilian u lëndua së fundmi dhe do të mungojë deri gjashtë javë. "Coutinho ka pësuar tërheqje muskulore në këmbën e djathtë. Nuk e di se sa do të jetë jashtë fushës së blertë, do ta shohim pas pauzës", ka deklaruar trajneri i ri i Aston Villës, Unai Emery.

#### Newcasteli interesohet për Hazardin

Reprezentuesi i Belgjikës dhe anëtar i Real Madridit, Eden Hazard, ka përfunduar në "radar" të Newcastle Unitedit. "Caughtoffside" raporton se klubi anglez po planifikon të bëjë ofertë për Hazardin në afatin kalimtar të janarit. Ai është i gatshëm të ofrojë 20 milionë euro për yllin belg, por mbetet të shihet nëse Real Madridi do ta pranojë ofertën e tyre. Newcastle Unitedi në këtë edicion po shkëlqen në Premierë Ligë dhe aktualisht pozicionohet në vendin e tretë me 27 pikë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke,  
Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrat e Publik, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit administrativ nr. 05/2021, Udhëzimi administrativ nr. 34/2014, Funkcionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, Udhëzimit administrativ nr. 05/2015, Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe kërkesave të Qendrave Burimore, shpall;

## KONKURS

Për vendet e lira të punës në Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim

Nr.	Pozita	Nr. i pozitave
1	Mësimdhënës për teori dhe praktikë profesionale për rrobaqepësi në AML QB "Nënë Tereza" në Prizren (rishpallje)	1
2	Mësuese klase në QB "Nënë Tereza" në Mitrovicë	1
3	Psikolog/e në QB "Lef Nosi" në Prizren (rishpallje)	1
4	Mësimdhënës për orientim dhe mobilitet në QB "Xheladin Deda" Pejë	1
5	Eduktor/e në konvikt në QB "Xheladin Deda" Pejë dhe QB "Lef Nosi" në Prizren (rishpallje)	2
6	Instruktor i gjuhës së shenjave në QB "Nënë Tereza" në Prizren (rishpallje)	1
7	Servuese në kuzhinë në QB "Nënë Tereza" dhe "Lef Nosi" në Prizren	2

### I. Punët dhe detyrat për mësimdhënës/e të rrobaqepësisë në lëndët mësimore teorike

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit të mesëm të lartë;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor dhe mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Udhëheqë klasën dhe përcakton detyrat për asistent ( mban dosje);
- Inicion dhe merr pjesë në planin individual të arsimit;
- Përdorë shkathtësi specifike për mësimdhënie në gjuhën e shenjave për nxënës me dëmtime në dëgjim;
- Bashkëpunon me mësuesit udhëtues, asistentët, bashkëpunëtorët profesional, drejtorin e QB dhe mësimdhënësit tjerë të QB;
- Jep ide, prodhon material alternativ për punë me FNV;
- Mban përgjegjësi për ruajtjen e mjeteve të punës dhe pajisjeve mësimore në klasë, etj.

#### 1. Përgatitja shkollore e mësimdhënësit të rrobaqepësisë në lëndët mësimore teorike:

- Msc. i tekstilit;
- Inxh. i dip. i tekstilit.

### II. Punët dhe detyrat kryesore të mësuesit/es të klasës:

- I realizon qëllimet dhe edukimit fillor;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Harton plane individuale për nxënës;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve.

#### 2. Përgatitja shkollore e mësuesit/es së klasës:

- Fakulteti i Filozofik – dega e pedagogjisë speciale;
- Departamenti i Pedagogjisë – edukimi për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Fakulteti i Edukimit- programi i arsimit fillor;
- Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë.

### III. Punët dhe detyrat e psikologut/es

- Identifikon nxënësit të cilëve u nevojitet ndihma dhe trajtimi adekuat psikologjik;
- Përpilon teste të bazuara për diagnostikimin e vështirësive në mësimdhënie;
- Mban lidhje me ekipet profesionale të qendrës burimore;
- Këshillon nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, këshillon zgjedhjen e profesionit ose të cilët kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
- Kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënës dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;

- Ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Vlerëson dhe interpreton çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënës dhe zhvillimit kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;
- Asiston dhe vlerëson nevojat e nxënësve, bashkëpunon me profesionist të tjerë dhe zbaton vlerësimet e përshtatshme (të besueshme dhe valide);
- Psikologu ka për detyrë të punojë drejtpërdrejtë me nxënës.

#### 3. Përgatitja shkollore e psikologut/es

- Niveli master në degën e Psikologjisë – drejtimi Psikologji shkollore dhe këshillim të Fakultetit Filozofik

### IV. Punët dhe detyrat kryesore të mësimdhënësit për orientim dhe mobilitet

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Kryen aktivitete – orë mësimore në fushën e Edukimit fizik dhe sportiv, duke u bazuar në specifikat e nxënësve të Qendrës Burimore;
- Angazhohet në orët për Orientim dhe mobilitet me nxënës, dhe fëmijë për të gjitha nivelet në Qendrën Burimore dhe në terren;
- Punon në shërbimet e mbështetjes apo si mësimdhënës i orientimit dhe mobilitetit për persona të verbër në mësimdhënie direkte duke fuqizuar shërbimet e mbështetjes për QBMK në terren etj.

#### 4. Përgatitja shkollore e mësimdhënësit për orientim dhe mobilitet

- Fakulteti i edukatës Fizike - Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor ( katërvjeçar 240).

### V. Punët dhe detyrat kryesore për edukator/e në konvikt:

- Bashkëpunojnë me arsimtarët që marrin pjesë në procesin mësimor;
- Bashkëpunojnë me mësimdhënësit e mësimi praktik dhe i dërgojnë nxënësit në mësimin praktik;
- Organizojnë dhe mbajnë këshilla me nxënësit rreth kryerjes së detyrave të shtëpisë;
- Kujdeset për nxënësit (në aspektin e edukimit, shëndetit, ushqimit, veshmbathjes dhe higjienës personale) etj.

#### 5. Përgatitja shkollore për edukatore në konvikt:

- Edukator/e – Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme

### VI. Punët dhe detyrat kryesore të instruktorit/es së gjuhës së shenjave

- Mbështet nxënësit dhe stafin e QB për gjuhën e shenjave;
- Ofron kurse të gjuhës së shenjave për stafin e QB dhe prindërit e nxënësve;
- Bashkëpunon me menaxherin dhe stafin e QB në promovimin e gjuhës së shenjave;
- Në bashkëpunim me stafin harton materiale për QB në gjuhën e shenjave.

#### 6. Përgatitja shkollore për Instruktor të gjuhës së shenjave

- Niveli baçelor – trajnimi për gjuhën e shenjave me 120 kredi (ECTS).

### VII. Punët dhe detyrat e servuesit/es

- E bën servimin e ushqimit në sallën e ushqimit ( mëngjesit, drekës dhe darkës);
- Është përgjegjës për pastërtinë e hapësirës së kuzhinës;
- Pastron inventarin në hapësirën e kuzhinës;
- Bën hedhjen mbeturinave të kuzhinës në deponi të caktuar të qendrës;
- Pastron enët dhe mjete tjera të ushqimit;
- Kryen dhe punë tjera që i cakton drejtori.

#### 7. Përgatitja shkollore për servues/e në kuzhinë

- Shkolla e mesme.

### Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: paragrafi 5 i nenit 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, paragrafi 2, 5, 7 të nenit 8, dhe paragrafi 3 i nenit 8 të UA nr. 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. UA nr. 34/2014 funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, respektivisht neni 2, paragrafi 4.2 paragrafi 1.1 i nenit 12 të UA nr. 05/2015, Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional.

**Sqarim shtesë:** – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmojnë me dokumente.

Mësimdhënësi për orientim dhe mobilitet do të punoj në shërbimet e mbështetjes për QB në terren. Kjo pozitë është për periudhën njëvjeçare.

E dëshirueshme për këtë pozitë është që kandidati të ketë njohuri rreth orientimit, mobilitetit. dhe rehabilitimit.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.

### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 08.11.2022 deri më 22.11.2022.

Formulari i aplikimit i plotësuar ( merret në uebfaqe të MASHTI

(<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar. Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstvo Obrazovanja  
Nauke Tehnologji e Inovacije- Ministry of Education, Science and Technology

Na osnovu člana 67. i 68. Zakona br. 06/L-114 za javne službenike, član 8, stav 1 i 2 Zakona o radu br. 03/L-212, (Službeni list Republike Kosovo, br. 90/2010), Zakon br. 04/L-032 za preduniverzitetsko obrazovanje u Republici Kosovo, Administrativno uputstvo 05/2021, Administrativno uputstvo br. 34/2014 Funkcionisanje pedagoško-psihološke službe u školama, Administrativno uputstvo br. 05/2015, Normativ za nastavnike profesionalnog obrazovanja, Administrativno uputstvo br. 02/2018 za Resursne centre, Administrativno uputstvo br. 07/2017 o Pravilniku o procedurama konkursa u javnom sektoru i zahtevima Resursnih centara, objavljuje:

## KONKURS

### Za slobodna radna mesta u Resorsnim centrima za nastavu i savetovanje

Br.	Položaj:	Br. pozicija
1	Nastavnik/ca za teoriju u stručnu praksu krojač/ca u VSO u RC "Majka Tereza" u Prizren (obnavlja)	1
2	Razredni učitelj u RC "Majka Tereza" u Mitrovica	1
3	Psiholog u RC "Lef Nosi" u Prizren (obnavlja)	1
4	Nastavnik za orijentaciju i mobilnost u RC "Xheladin Deda" Peć	1
5	Vaspitač/ca u dom za stanovanje u RC "Xheladin Deda" Peć i RC "Lef Nosi" u Prizren (obnavlja)	2
6	Instruktor znakovnog jezika u RC "Majka Tereza" u Prizren (obnavlja)	1
7	Serviserka u kuhinji RC "Majka Tereza" i "Lef Nosi" u Prizren	2

#### I. Radni zadaci nastavnika/ce krojač/ca nastavni predmet teorije

- Ispunjava ciljeve i obaveze više srednjeg obrazovanja za;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;
- Vodi razred i određuje zadatke za asistenta (vodi evidenciju);
- Inicira i učestvuje u individualni plan obrazovanja;
- Koristite specifične veštine za nastavu znakovnom jeziku za učenike sa oštećenjem sluha;
- Saraduje sa putujućim nastavnicima, asistentima, stručnim saradnicima, direktorom RC i ostalim nastavnicima RC;
- Daje ideje, izrađuje alternativne radne materijale sa DPP;
- Snosi odgovornost za održavanje radnog alata i nastavne opreme u razred, itd

#### 1. Školska sprema nastavnika krojača/ce iz nastavnog predmeta teorije:

- Msc. tekstila;
- Dip. ing. tekstila.

#### II. Glavni zadaci i obaveze razrednog/ne učitelja/ce:

- Ispunjava ciljeve i obaveze osnovnog obrazovanja i vaspitanja;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Sastavlja individualne planove za učenike;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;

#### 2. Školska sprema razrednog/e učitelja/ce:

- Filozofski fakultet– smer specijalna pedagogija;
- Departament pedagogije– Vaspitanje za decu sa posebnim potrebama
- Edukativni fakultet - program osnovno obrazovanje;
- Filozofski fakultet - smer pedagogija

#### III. Zadaci i obaveze psihologa

- Identifikuje učenike kojima je potrebna odgovarajuća psihološka pomoć i lečenje;
- Sastavlja testove zasnovane na dijagnosticiranju poteškoća u nastavi;
- Održava vezu sa profesionalnim timovima resursnog centra;
- Savetuje učenike kojima je potrebna pomoć u učenju, kontinuiranom radu, savetuje izbor profesije ili koji imaju potrebe za savet za prevazilaženje ličnih problema;
- Doprinosi u olakšavanju procesa učenja i promovise kognitivni emotivni, Socijalni lični razvoj učenika;
- Pruža pomoć u prevazilaženju teškoća psihološke prirode kod svim akterima u školi;
- Ocenjuje i interpretira pitanja vezana za proces učenja i kognitivni, emocionalni, socijalni i lični razvoj učenika.
- Pomaže i procenjuje potrebe učenika, saraduje sa drugim profesionalcima i sprovodi odgovarajuće (pouzdanje i validne) procene.
- Psiholog ima obavezu da radi direktno sa učenicima.

#### 3. Školska sprema psihologa

- Nivo master Psihologije - smer Školska psihologija i savetovanje Filozofski

#### IV. Glavni zadaci i obaveze nastavnika za orijentaciju i mobilnosti

- Da realizuje nastavni plan i program za odgovarajuće radno mesto na osnovu Zakona o pred-pred-univerzitetsko obrazovanju u Republici Kosovo i drugih podzakonskih akata koji regulišu odgovarajuće relevantne oblasti za njegov/njeno radno mesto.
- Da realizuje radne zadatke obezbeđujući kvalitet i profesionalne kompetencije u nastavnom procesu.
- Obavlja aktivnosti- nastavni čas iz oblasti Fizičko vaspitanje i sportovi u skladu sa specifičnosti učenika u Resornom centru.
- Angažuje sa na čas za orijentaciju i mobilnost sa učenicima, i decu svih nivoa Resornom centru i na terenu.
- Radi u službama podrške ili kao nastavnik za orijentaciju i mobilnosti za slepe osobe u direktnoj nastavi, jačajući službe podrške RCNK-u na terenu itd.

#### 4. Školska sprema za nastavnika za orijentaciju i mobilnost

- Fakultet fizičkog vaspitanja - nivo Master u obrazovanju (300 ECTS)
- Četvorogodišnji sistem
- Bachelor (četvorogodišnji 240)

#### V. Glavni zadaci i obaveze vaspitača/će za u dom:

- Saraduje sa nastavnicima koji učestvuju u nastavnom procesu;
- Saraduje sa nastavnicima praktične nastave i šalju učenike na praktičnu nastavu;
- Organizuje i održava savetovanje sa učenicima o obavljanju domaćih zadataka;
- Stara se za učenike (u pogledu vaspitanja, zdravlja, ishrane, odeće i lične higijene) itd

#### 5. Školska sprema za vaspitača/ce u dom:

- Vaspitač/ca - Filozofski fakultet, - smer opšta pedagogija;

#### VI. Glavni zadaci i obaveze Instruktor/ke znakovnog jezika:

- Podržava učenike i osoblje RC u znakovnom jeziku;
- Omogućava kurseve znakovnog jezika za osoblje RC i roditelje učenika;
- Saraduje sa menadžerom i osobljem RC u promociji znakovnog jezika;
- U saradnji sa osobljem sastavlja materijale za RC na znakovnom jeziku.

#### 6. Školska sprema za Instruktor znakovnog jezika

- Nivo bachelor– obuka znakovnog jezika sa 120 kredita (ECTS).

#### VII. Zadaci i obaveze sestre vaspitačice u/ce

- Vršiti serviranje hrane u sali za ručavanje (doručak, ručak i večera);
- Odgovoran je za higijenu u kuhinji;

- Čisti inventar u kuhinjskim prostorijama
- Izbacuje smeće iz kuhinje na određenj deponiji;

- Pere suđe i ostale alate u kuhinji;

- vrši i druge poslove koje mu odredi direktor

#### 7. Školska sprema osobu koja servira u kuhinji

- Srednja škola

#### Uslovi konkursa

Izbor kandidata vrši se na osnovu kriterijuma Zakona koji regulišu oblast obrazovanja: stav 5. člana 35. Zakona br. 04 / L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo stav 2,5,7 člana.8 i stav 3 član 8 AU br. 05/2021 o Normativom za stručni kadar opšteg obrazovanja AU br.34/2024 funkcionisanje pedagoško-psihološke službe u školi, odnosno član 2 stav 4.2 stav 1.1 člana 12 AU br. 05/2015, Noramtiv za nastavnike stručnog obrazovanja

**Dodatno pojašnjenje:** -Informacije prikazane u aplikaciji smatraju se validnim samo u koliko budu potkrepljeni dokazom

Nastavnik orijentacije i mobilnosti će raditi u službama podrške za RC na terenu. Ova pozicija je na period od godinu dana.

Za ovu poziciju poželjno je da kandidat ima znanja o orijentaciji, mobilnosti. i rehabilitaciju.

Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju dostaviti da je izvršena nostrifikacija dokumenta od strane MONTI-a.

Na pismenom intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa. Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

#### Rok i način apliciranja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana, aplikacije se dostavljaju od dana 08.11.2022 do dana 22.11.2022.

Popunjeni obrazac za apliciranje ( dobija se na web stranici MONTI-a

(<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Diploma kvalifikacije (ili sertifikat) sertifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Kandidati, dokumenta trebaju predati u relevantni Resursni centar / Specijalnu školu u kojoj konkurišu. Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA  
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85  
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, dhe nevojës urgjente të Kompanisë, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 08.11.2022, vendosi të publikoj këtë:

### KONKURS

**Pozita: Inkasantë (me kontratë një vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese tre muaj),**

**Vendi Deçan: (2 pozita).**

-Bëjnë pastrimin e kanaleve të ujitjes sipas planifikimit nga Menaxheri i Njësisë, bëjnë kontraktimin e ujit, shpërndarjen e ujit, dhe pagesat nga fermerët, më rastin e pagesave janë të obliguar të lëshojnë kontrata dhe dëftesat e pagesave.

**Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.**

- Kualifikimi i mesëm shkollor.

**Procedura e aplikimit:**

Dokumentet dorëzohen ne zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "8Twenty Energy" L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaik (50+50) MW në Zllakuqan, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.12.2022 në ora 09:00 pranë ambienteve të Komunës së Klinës, adresa : Rr: "Abedin Rexha", Kline 32000 do të organizohet debat publik nga Kompania "8Twenty Energy" L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaik (50+50) MW në Zllakuqan, Klinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/72035624148?pwd=VZCce3Kbl1QtQe8DkMZZspkBlO08d.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "8Twenty Energy" L.L.C. Prishtinë për impiantin fotovoltaik (50+50) MW në Zllakuqan, Klinë.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ermal Maloku, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Blerta Sinani shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit drejtimi Infermieri të Kolegjit AAB- Prishtinë.

- Blerta Sinani shpall të pavlefshme tri dëftesat dhe Diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

- Lumturije Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Borë Shehu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M "Selman Riza", nga klasa e -I- deri -VIII-, Gjakovë.

- Valon Azemaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -IX- të SH.M.T "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

